



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**  
**KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE**

**VENDIM**  
**Nr. 09 Datë 23.10.2020**

**PËR VERIFIKIMIN E DEKLARIMEVE NË FORMULARIN E VETËDEKLARIMIT TË KANDIDATIT ZJ. BRUNILDA HAMIT SOGANI NGA LISTA SHUMEMËRORE PËR KËSHILLIN E BASHKISË GRAMSH, NË ZBATIM TË LIGJIT NR. 138/2015 “PËR GARANTIMIN E INTEGRITETIT TË PERSONAVE QË ZGJIDHEN, EMËROHEN OSE USHTROJNË FUNKSIONE PUBLIKE”**

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 19, pika 1, germa “n” dhe pika 2 i Ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; neni 11 i ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”; Kreu V i Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur;

**VËREN**

Me shkresën nr. 1729 prot., datë 26.05.2020, këshilli i bashkisë Gramsh ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës, për arsye të përfundimit të parakohshëm të mandatit të këshilltarit zj. Luljeta Kalem Dollani.

Referuar nenit 164 të Kodit Zgjedhor, kandidati vijues nga lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, për këshillin e bashkisë Shijak, të cilit i kalon mandati i këshilltarit, është kandidati me numër rendor 13, zj. Brunilda Hamit Dollani.

Më datë 05.06.2020, zj. Brunilda Hamit Dollani, kandidat i rradhës nga lista shumëemërore e subjektit Politik Partia Socialiste e Shqipërisë, këshilli bashkiak Gramsh, ka sjelle formularin e vetëdeklarimit pa kërkesën përkatëse nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Referuar nenit 11 të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumemërore për zgjedhjet pararendëse, për këshillin bashkiak, të cilit i takon të marrë mandatin e këshilltarit për vendin vakant.



Kandidati për këshilltar përcaktuar në bazë të listës shumëmemërore të subjektit politik Partia Socialiste e Shqipërisë, ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit me numër 0029 unik, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik ku përfshihet dhe funksioni i këshilltarit të bashkisë.

Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit të kandidatit për anëtar zj. Brunilda Hamit Sogani, në këshillin e bashkisë Gramsh, rezulton se: Në rubrikën I. "TË DHËNA PERSONALE", PIKA B, "Gjeneralitete të mëparshme" të Formularit të Vetëdeklarimit, subjekti vetëdeklarues ka deklaruar gjeneralitete e saj dhe është shprehur se ka ndryshuar mbiemrin nga "Kishta" në "Sogani".

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe Kreut V, pika 2, germa "b" dhe pikës 10.06.2020 ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe me shkresën nr. 1167 prot., datë 11.06.2020 ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore për kandidatin për anëtar zj. Brunilda Hamit Sogani, në Këshillin e Bashkisë Gramsh, që ka dorëzuar formularin e vetëdeklarimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si dhe ka bërë publikimin e formularit të vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Civile me shkresën nr. 4275/1 prot., datë 08.07.2020 ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes civile për kandidatin për anëtar zj. Brunilda Hamit Sogani, në këshillin e bashkisë Gramsh, nga ku rezulton se nuk ka kryer ndryshime në përbërësit e gjendjes civile.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore me shkresën nr. 5626/1 prot., datë 12.06.2020 ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatin për anëtar zj. Brunilda Hamit Sogani, në këshillin e bashkisë Gramsh, i cili rezulton me status i padënuar nga gjykatat shqiptare.

Me shkresën 1848 prot., datë 03.06.2020 (KQZ nr. 1133 prot., datë 08.06.2020), Kryetari i Bashkisë Gramsh, informon Komisionin Qendror të Zgjedhjeve se, Prefekti Elbasan ka vlerësuar si të paligjshëm Vendimin e këshillit të bashkisë Gramsh, për deklarimin e mbarimit të parakohshëm të mandatit të znj. Luljeta Kalem Dollani, për shkak të mungesës së kuorumit në vendimmarrje dhe mungesës së nënshkrimit të vendimit/ njoftimit të vakancës nga Sekretari i Këshillit të Bashkisë.

Me shkresën nr. 2859 prot., datë 07.08.2020 këshilli i bashkisë Gramsh, i është drejtuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, duke e njoftuar se Prefekti nuk mund të bëjë vlerësimin e akteve të këshillit me karakter individual, por mund të vlerësojë ligjshmërinë e akteve (vendime, urdhëra, urdhëresa) me karakter normativ që nxjerr këshilli i bashkisë, pa penguar zbatimin e tyre.

Me shkresën nr. 3278 prot., datë 02.09.2020 (KQZ nr. 1500 prot., datë 05.09.2020) kryetarja e këshillit të bashkisë Gramsh zj. Greta Lena, ka kërkuar informacion nëse kandidatja për anëtare e këshillit bashkiak zj. Brunilda Hamit Sogani është ose jo në kushtet e ndalimit për ushtrimin e mandatit.

Me shkresën nr. 3839 prot., (KQZ Nr. 1626 prot., datë 12.10.2020) Kryetari i Bashkisë Gramsh kërkon nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, që bazuar në nenin 164/4 të Kodit Zgjedhor të ndryshuar, shpalljen absolutisht të pavlefshme të vendimit nr. 45 datë 20.05.2020 të këshillit bashkiak Gramsh, për deklarimin e e mbarimit të mandatit para kohe të zj. Luljeta Kalem Dollani, dhe të



vendimit nr. 62, datë 30.09.2020 “Dhënie mandati këshilltari” për shkak të dhenies së mandatit para shpalljes së rezultateve të verifikimit nga KQZ.

Ligji 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe Kodi Zgjedhor nuk i njeh KQZ asnjë kompetencë verifikimi ligjshmërie të vendimmarjeve të organeve të qeverisjes vendore por ua njeh këtë kompetencë organeve të tjera si Kryetari i bashkisë dhe Prefekti, të cilët në rast të konstatimeve të paligjshmërisë së vendimmarjes së organeve të qeverisjes vendore i drejtohen gjykatës kompetente.

Kompetenca e vetme që Kodi Zgjedhor dhe Ligji nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen apo ushtrojnë funksione publike”, i njeh KQZ, në raport me vakancat e krijuara në këshillat bashkiak është monitorimi dhe respektimi i parimit të barazisë gjinore si dhe të administrimit dhe verifikimit të formularëve të vetëdeklarimit. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për plotësimin e vakancave të krijuara vihet në lëvizje në bazë të njoftimit të vakancës dërguar nga organi kompetent, që është Këshilli i Bashkisë.

Mbi bazën e këtij njoftimi Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, identifikon mbi parimin e barazisë gjinore, nëse plotësimi i vakancës me kandidatin e radhës ul përfaqësimin e gjinisë së nënpërfaqësuar, dhe vijon procedurat e njoftimit të kandidatit të radhës sipas këtij parimi, të dorëzojë formularin e vetëdeklarimit dhe të procedojë në përputhje me përcaktimet e vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen apo ushtrojnë funksione publike”.

Në këtë kuadër KQZ, në përfundim të procesit të verifikimit të formularëve të vetëdeklarimit si dhe duke njohur kompetencën e këshillit të bashkisë për dhënien e mandatit të anëtarit të këshillit, konkludon nëse kandidati i radhës (subjekti vetëdeklarues) përbën kusht për zgjedhjen apo moszgjedhjen e tij/ saj në funksionin e këshilltarit dhe njofton këshillin për vazhdimin e procedurave për dhënien e mandatit nga këshilli i bashkisë.

Për sa me sipër, referuar nenit 49 të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” këshilli i bashkisë ka kompetencën për dhënien e mandatit, anëtarit të këshillit bashkiak.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, referuar pikës 2, paragrafi i fundit, të Kreut V të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit konstaton se, për kandidatin për anëtar zj. Brunilda Hamit Sogani, në këshillin e bashkisë Gramsh, të dhënat nuk përbëjnë kusht për mos zgjedhjen e kandidatit në funksionin e këshilltarit.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 19, pika 1, germa “n” dhe pika 2 i Ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; nenin 11, i ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”; Kreu V, i Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.



## VENDOSA:

1. Zj. Brunilda Hamit Sogani, kandidat për anëtar në këshillin e bashkisë Gramsh, të subjektit politik Partia Socialiste e Shqipërisë, nuk përfshihet në kushtet e moszgjedhshmërisë për ushtrimin e funksionit.
2. Vazhdimin e procedurave nga këshilli i bashkisë Gramsh, për dhënien e mandatit, kandidatit të listës shumëmemërore zj. Brunilda Hamit Sogani, të subjektit politik Partia Socialiste e Shqipërisë, për plotësimin e vendit vakant në Këshillin e Bashkisë.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga shpallja e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONER**

**Birjan CELIBASHI**

